Në secilin prej tre viteve të fundit, pjesa më e madhe e spoteve të reklamave janë porositur nga industria ushqimore dhe nga industria e pijeve joalkoolike (pjesëmarrja në vitin 2012 është më e madhe – 19,27%) .

Industritë më të mëdha të shpalljeve në tre vitet e fundit

2012		2011		2010	
ushqim dhe pije joalkoolike	19.27%	ushqim dhe pije joalkoolike	17,75%	ushqim dhe pije joalkoolike	17,60%
shpallje politike dhe aksione humanitare	8.47%	transport	10,37%	transport	10,70%
Telekomunikime	8.43%	reklamim politik	9,37%	telekomunikime	8,33%
produkte kozmetike	7.63%	telekomunikime	7,62%	media	7,25%
artikuj mjekësorë dhe sanitarë	7.52%	produkte kozmetike	6,35%	shërbime	6,60%
të tjera	48.68%	të tjera	48.54%	të tjera	49.52%

Industria e telekomunikimit ka qenë në mesin e pesë industrive më të rëndësishme në të tre vitet, ndërsa reklamimi politik dhe aksionet humanitare, si dhe industria e produktve kozmetike vetëm në dy vitet e fundit.

Për herë të parë në vitin 2012, në mesin e pesë industrive më të rëndësishme është industria e artikujve mjekësorë dhe sanitarë.

Industria e transportit, e cila në dy vitet e mëparshme ka qenë në vendin e dytë, në vitin 2012 është në vendin e tetë.


Në vitin 2010, mediat kanë qenë në vendin e katërt, në vitin vijues në vendin e dymbëdhjetë, ndërsa në vitin 2012 në vendin e katërmbëdhjetë.

Pjesëmarrja në të hyrat nga reklamimi në televizionet në nivel shteti

Në vitin 2012, stacionet televizive terestriale që emetojnë program në nivel shteti (dy kanalet programore të servisit radiodifuziv publik– MTV1 dhe MTV2, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Alsat-M dhe TV Telma) nga shitja e kohës për reklamim kanë realizuar gjithsej 1.139,64 milionë denarë.

Pjesën më të madhe të këtyre mjeteve ka arritur ta realizojë TV Sitel (586,61 milionë denarë), përkatësisht 51% nga të hyrat e përgjithshme nga reklamimi te ky segment i industrisë televizive.

pjesëmarrja në të hyra



Në vendin e dytë është TV Kanal 5, me gjithsej 276,78 milionë denarë të realizuara nga reklamimi dhe me pjesëmarrje prej 24% në të hyrat e përgjithshme.

TV Alsat-M ka treguar të hyra nga shitja e kohës për reklamim në shumë prej 144,87 milionë denarësh, ndërsa TV Telma në shumë prej 77,1 milionë denarësh.

Më pak të hyra nga reklamimi ka shënuar Televizioni Maqedonas (54,29 milionë denarë) ose vetëm 5% nga torta e reklamave.

1.3. *Televisione satelitore*

Në fillim të vitit, leje për të emetuar program televiziv përmes satelitit kishin gjithsej 12 subjekte – TV Sonce, TV AB Kanal, TV BM, TV Nasha, TV Sitel 3, TV 24 Vesti, TV Jungle, TV Alfa, TV Kanal 5 plus, TV A2, TV Pink 15 dhe TV Perspektiva (TV Skajnet plus).

Gjysma e tyre gjatë vitit e humbën të drejtën për të kryer veprimtari radiodifuzive (TV BM⁷, TV Jungle⁸, TV Perspektiva (TV Skajnet plus)⁹, TV Pink 15¹⁰, TV A2¹¹ dhe TV AB Kanal¹²).

Gjatë tërë vitit program kanë emetuar vetëm gjashtë televizione satelitore (TV Sonce, TV Nasha, TV Sitel 3, TV 24 Vesti, TV Alfa dhe TV Kanal 5 plus).

Konform lejeve për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive, këto subjekte emetojnë program në nivel shteti, përkatësisht tërë territorin e shtetit. Publiku maqedonas i pranon këto kanale vetëm përmes kontratave parapaguese me ndonjë nga operatorët e rrjeteve komunikuese publike.

Sipas të dhënave nga „Hulumtimi i mendimit të publikut“, të cilin për nevojat e Këshillit të Radiodifuzionit në gusht të vitit 2012 e realizoi Instituti për Demokraci, 81% e të anketuarve janë përgjigjur se i shfrytëzojnë shërbimet e operatorëve të rrjeteve komunikuese publike. Këtu hyjnë parapaguesit e Max TV, që e shfrytëzon teknologjinë Internet protokoll (10%), parapaguesit e Boom TV që bën riemetim digjital (9%) dhe parapaguesit e rreth 64 operatorëve kabllorë aktiv (62%).

Së këndejmi, rrezja maksimale e këtyre stacioneve televizive është 81% e publikut, po qe se janë të regjistruar në paketat programore të të gjithë operatorëve të rrjeteve komunikuese publike.

⁷ Për shkak se nuk ka filluar ta kryejë veprimtarinë në afatin e përcaktuar në leje (Vendim nr..07/91 dt. 02.04.2012)

⁸ Për shkak se nuk ka filluar me emetimin e servisit programor përmes satelitit dhe për shkak se nuk e ka paguar kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar me leje (Vendimi nr..07-100 dt. 10.04.2012)

⁹ Për shkak se nuk ka filluar me emetimin e servisit programor përmes satelitit dhe për shkak se nuk e ka paguar kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar me leje (Vendimi nr.07/101 dt. 10.04.2012).


¹⁰ Për shkak se nuk e ka paguar kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar me leje (Vendimi nr..07-152 dt. 11.05.2012).

¹¹ Për shkak të mosplotësimit të kushteve nga leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive, përkatësisht për shkak se nuk i është përmbajtur formatit për të cilin është ndarë leja (Vendimi nr.07-192 dt. 13.06.2012).

¹² Për shkak se nuk e ka paguar kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar me leje (Vendimi nr..07-325 dt. 26.09.2012).

Në paketat programore të pothuajse të gjithë operatorëve të rrjeteve komunikuese publike, në përjashtim të disave me më pak parapagues, janë TV Nasha, TV Sitel 3, TV Kanal 5 plus dhe TV Alfa.

çfarë lidhje ka pranuesi kryesor TV në am




Në vitin 2012, TV Sonce nuk e kanë rriemtuar rreth 28 operatorë, në mesin e të cilëve edhe BOOM TV (parapaguesit e të cilit sipas të dhënave nga „Hulumtimi i mendimit të publikut“ përbëjnë rreth 9% nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Maqedoni), ndërsa TV 24 Vesti nuk e kanë rriemtuar rreth 30 operatorë të rrjeteve komunikuese publike, në mesin e të cilëve edhe BOOM TV dhe Blizoo (Blizoo është një nga operatorët me më shumë parapagues). Së këndejmi, rrezja e këtyre dy televizioneve deri te publiku është më e vogël se 81%.

Në vitin 2012, të hyrat e përgjithshme që kanë realizuar këto gjashtë stacione televizive kanë arritur 184,99 milionë denarë.

Më shumë se gjysma nga këto mjete (51,50%) kanë qenë të hyrat e TV Alfa (95,27 milionë denarë). Pjesëmarrje më të dukshme kanë pasur edhe të hyrat e TV Nasha (23,23% përkatësisht 42,97 milionë denarë) dhe të TV Kanal 5 plus (19,91% përkatësisht 36,82 milionë denarë). Këto tri televizione kanë realizuar 94,64% nga të hyrat e këtij segmenti nga tregu televiziv.

Tre televizionet tjera satelitore kanë realizuar dukshëm më pak të hyra: TV 24 Vesti – 6,82 milionë denarë, TV Sonce – 2,49 milionë denarë dhe TV Sitel 3 – 0,62 milionë denarë.


pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme e televizi



Në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2012, të hyrat e përgjithshme që kanë pasur këto gjashtë televizione kanë qenë me vlera të ndryshme. Në krahasim me vitin e mëparshëm, ato kanë qenë më të larta për 2,12%.

Vetëm dy televizione (TV Nasha dhe TV Kanal 5 plus) kanë shënuar hyrje në të gjithë gjashtë vitet. TV Kanal 5 plus nga viti në vit i ka rritur të hyrat e përgjithshme, në dallim nga TV Nasha, tek e cila shkalla e rritjes disa vite ka vlerë pozitive (në vitin 2009 dhe në vitin 2011), ndërsa disa vite vlerë negative (në vitin 2010 dhe në vitin 2012).

lëvizja e të hyrave të përgjithshme te 6 televizionet pesë vitet e fundit



TV Alfa ka shënuar të hyra prej vitit 2009, ndërsa shkalla e rritjes në kontinuitet ka pasur vlera pozitive. Në vitin 2012 të hyrat e këtij televizioni kanë qenë për 55,83% më të larta nga të hyrat në vitin 2011.

TV 24 Vesti, TV Sonce dhe TV Sitel 3 kanë realizuar të hyra vetëm në vitin 2011 dhe në vitin 2012, edhe atë: TV 24 Vesti - 6,08 milionë denarë, përkatësisht 6,82 milionë denarë, TV Sonce - 1,77 milionë denarë, përkatësisht 2,49 milionë denarë dhe TV Sitel 3 - 3,08 milionë denarë, përkatësisht 0,62 milionë denarë.

Në vitin 2012, burimi më i rëndësishëm i të hyrave i televizioneve satelitore kanë qenë të hyrat nga shitja e kohës për reklamim dhe teleshoping. Pjesëmarrja në të hyrat nga reklamat në të hyrat e përgjithshme të secilit televizion veç e veç lëviz nga 96,46% te TV Alfa, deri në 100% te TV Kanal 5 plus.

Struktura e të hyrave te televizionet satelitore	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshoping	181.20	97.95%
Sponsorime	0.00	0.00%
Të hyra nga programe të tjera	0.00	0.00%
Donacione dhe grante	0.00	0.00%
Shitja e programeve	0.00	0.00%
Të hyra të tjera të pashpërndara	2.67	1.44%
Të hyra nga veprimtaria bazë	183.87	99.39%
Të hyra nga veprimtari të tjera	0.41	0.22%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.71	0.38%
Gjithsej të hyra	184.99	100.00%

Më shumë të hyra nga reklamat kanë shënuar: TV Alfa (91,9 milionë denarë), TV Nasha (42,58 milionë denarë) dhe TV Kanal 5 plus (36,82 milionë denarë).

Dukshëm më pak të hyra nga reklamat kanë shënuar TV 24 Vesti (6,79 milionë denarë), TV Sonce (2,5 milionë denarë) dhe TV Sitel 3 (0,62 milionë denarë).

Në vitin 2012, të gjashtë televizionet satelitore bashkë kanë harxhuar gjithsej 222,34 milionë denarë. Pothuajse gjysma e këtyre mjeteve kanë qenë shpenzime të përgjithshme të TV Alfa (105,77 milionë denarë).

pjesëmarrja në shpenzimet e përgjithshme e satelitore



Shpenzimet e përgjithshme të pesë televizioneve të tjera kanë qenë: TV 24 Vesti - 40,3 milionë denarë, TV Nasha - 29,99 milionë denarë, TV Kanal 5 plus - 25,4 milionë denarë, TV Sonce – 17,8 milionë denarë dhe TV Sitel 3 – 3,1 milionë denarë. .

Shpenzimet e përgjithshme të këtyre gjashtë subjekteve në tre vitet e fundit shënojnë rritje. Në vitin 2011 shpenzimet e përgjithshme kanë qenë për 27,55% më të larta se sa shpenzimet në vitin 2010, ndërsa në vitin 2012 për 1,08% më të larta se sa shpenzimet në vitin 2011. Kjo më shumë shkakut i rritjes së shpenzimeve të TV 24 Vesti, të cilat në vitin 2010 kanë qenë 3,97 милиони, në vitin 2011 33,43 milionë denarë, ndërsa në vitin 2012 40,3 milionë denarë.

Stacioni TV	Shpenzime të përgjithshme		
	2010	2011	2012
TV Alfa	116.45	111.69	105.77
TV 24 Vesti	3.97	33.43	40.3
TV Nasha	24.88	27.95	29.99
TV Kanal 5 plus	15.97	25.76	25.4
TV Sonce	11.97	18.15	17.8
TV Sitel 3	0.00	3.98	3.1
GJITHSEJ	173.24	220.96	222.34

Pjesa më e madhe e mjeteve janë destinuar për rroga dhe kompensime të tjera për personat direkt të lidhur me prodhimin e programit (36,30%). Për këtë lloj shpenzimi TV Alfa ka ndarë më shumë mjete (50,20 milionë denarë) se sa pesë televizionet bashkë (30,51 milionë denarë). Në vitin e analizuar, TV Sitel 3 nuk ka paraqitur shpenzim të këtillë (në vitin 2012 në këtë televizion asnjë njeri nuk ka qenë i punësuar me marrëdhënie të rregullt pune).

Pjesëmarrje më të dukshme në shpenzimet e përgjithshme kanë shpenzimet për sigurimin e programit. Vetëm tri televizione kanë ndarë mjete për sigurimin e programit: TV Nasha (24,01 milionë denarë), TV Alfa (17,35 milionë denarë) dhe TV Kanal 5 plus (0,13 milionë denarë).

Struktura e shpenzimeve te televizionet satelitore		
	2012	pjesëmarrja
Shpenzime materiale	19.65	8.84%
Shpenzime për sigurimin e programit	41.49	18.66%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	6.01	2.70%
Rroga dhe kompensime të tjera për personat direkt të lidhur me prodhimin e programit	80.71	36.30%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	147.86	66.50%
Rroga dhe kompensime të tjera për personat që nuk janë të lidhur direkt me prodhimin e programit	2.55	1.15%
Amortizimi i pajisjes	6.90	3.10%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.00	0.00%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	17.26	7.76%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira nga puna	43.79	19.69%
Shpenzime të përgjithshme të punës	218.37	98.21%
Të dala nga aktivitete të tjera	3.98	1.79%
Të dala të jashtëzakonshme	0.00	0.00%
Shpenzime të përgjithshme të punës	222.34	100.00%

Më shumë mjete për qira dhe shpenzimet tjera nga detyrimet ka harxhuar TV Alfa (14,88 milionë denarë). Pjesëmarrja e lartë e „të gjitha shpenzimeve të tjera të papërfshira nga puna“ ka të bëjë me shumën e larta që i kanë paraqitur TV Alfa (18,00 milionë denarë) dhe TV Kanal 5 plus (18,63 milionë denarë).


Rezultati i arritur nga puna e këtij segmenti të industrisë televizive ka qenë humbja në shumë prej 37,76 milionë denarësh.

Vetëm dy televizione kanë shënuar fitim: TV Nasha (12,83 milionë denarë) dhe TV Kanal 5 plus (11,43 milionë denarë).

Rezultati i arritur nga puna te televizionet satelitore	
	2012
Të hyra nga veprimtaria bazë	184.60
Shpenzime të përgjithshme të punës	218.51
Fitim (humbje) nga veprimtaria bazë	-33.92
Të hyra nga aktivitete të tjera	0.39
Të dala nga aktivitete të tjera	3.83
Fitim (humbje) nga aktivitete të tjera	-3.44

Të hyra të jashtëzakonshme	0.00
Të dala të jashtëzakonshme	0.00
Fitim (humbje) para tatimit	-37.36
Fitim (humbje) pas tatimit (Fitimi/humbja neto)	-37.76

Rezultat më të keq financiar ka pasur TV 24 Vesti (humbje prej 33,49 milionë denarë), ndërsa me humbje kanë punuar edhe TV Sonce (15,31 milionë denarë), TV Alfa (10,73 milionë denarë) dhe TV Sitel 3 (2,48 milionë denarë).



Numri i përgjithshëm i personave me punë të rregullt te televizionet satelitore ka qenë 241, prej të cilëve gjysma kanë qenë në TV Alfa. Në TV Sitel 3 me marrëdhënie të rregullt nuk ka qenë i angazhuar asnjë person.

numri i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune në katër vitet e fundit				
Stacioni TV	2009	2010	2011	2012
TV Alfa	72	127	121	120
TV 24 Vesti	0	25	59	64
TV Kanal 5 plus	37	32	28	24

TV Sonce	7	12	12	19
TV Nasha	35	35	16	14
TV Sitel 3	0	0	0	0
GJITHSEJ	151	231	236	241

Në krahasim me vitin e mëparshëm, numri i të punësuarve është rritur për 5 persona. Dy televizione e kanë rritur numrin e të punësuarve: TV Sonce (për 7 persona) dhe TV 24 Vesti (për pesë persona), ndërsa tri e kanë zvogëluar: TV Alfa (për një person), TV Kanal 5 plus (për 4 persona) dhe TV Nasha (për 2 persona).


1.4. Televizione rajonale

Në vitin 2012, program televiziv në nivel rajonal kanë emetuar gjithsej 10 stacione televizive. Një prej tyre – TV Pink Mak ka emetuar program vetëm në gjysmën e parë të vitit¹³, e duke qenë se në periudhën e grumbullimit të të dhënave tashmë s'e kishte lejen për të kryer veprimtarinë radiodifuzive, të dhënat për punën ekonomike të këtij subjekti në vitin 2012 nuk janë përfshirë në Analizë.¹⁴

Nëntë stacionet televizive që kanë kryer veprimtari radiodifuzive gjatë tërë vitit kanë shënuar të hyra të përgjithshme në shumë prej 57,54 milionë denarësh.

Pjesën më të madhe, përkatësisht 35% nga këto mjete, ka shënuar TV Era. Ky televizion, bashkë me vetëm tri të tjera (TV Skopje, TV MTM dhe TV BTR) kanë shënuar pothuajse 80% të të hyrave të përgjithshme në tregun televiziv rajonal.

pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme e televizi




Në krahasim me vitin e mëparshëm, të hyrat e përgjithshme shënojnë rritje të butë (për 3,82%). Megjithatë, ato dukshëm janë më të vogla se sa të hyrat e realizuara në tre vitet e para, edhe atë për 28,66% se sa të hyrat e realizuara në vitin 2008, për 34,44% në krahasim me të hyrat në vitin 2009 dhe për 32,73% në krahasim me të hyrat në vitin 2010.

¹³ Për shkak se nuk është paguar kompensimi për lejen në afatin e paraparë në leje, me vendim të Këshillit nr. 07-249 dt. 11.06.2012 ky radiopërhapës e humbi të drejtën e kryerjes së veprimtarisë radiodifuzive.

¹⁴ Në vitin 2011 të hyrat e përgjithshme të TV Pink kanë shënuar vetëm 1.667,00 denarë.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme te stacione pesë vitet e fundit



Rënia e dukshme e të hyrave të përgjithshme në vitin 2011, në raport me vitin 2010, në masë më të madhe ka të bëjë me rënien e të hyrave të TV Era (për 62.82%, përkatësisht për 29,86 milionë denarë).

Në vitin 2012, prej nëntë televizioneve, gjithsej gjashtë kanë shënuar më shumë të hyra në krahasim me një vit më parë: TV Shutel (për 11,69%), TV Skopje (për 0,29%), TV Amazon (për 60,19%), TV Era (për 14,09%), TV KRT (për 144,44%) dhe TV Skajnet (për 24,56%).

Tre televizionet tjera kanë pasur më pak të ardhura se një vit më parë, edhe atë TV BTR (për 22,85%), TV Edo (për 18,10%) dhe TV MTM (për 3,60%).

të hyra të përgjithshme në katër vitet e fundit							
Stacioni TV	2009	Shkalla e rritjes	2010	Shkalla e rritjes	2011	Shkalla e rritjes	2012
TV Shutel	2.01	-17.91%	1.65	50.30%	2.48	11.69%	2.77
TV Skopje	35.05	-63.25%	12.88	-20.57%	10.23	0.29%	10.26
TV Amazon	1.86	-29.03%	1.32	-18.18%	1.08	60.19%	1.73
TV BTR	3.26	32.52%	4.32	91.44%	8.27	-22.85%	6.38
TV Edo	0.46	530.43%	2.9	16.21%	3.37	-18.10%	2.76
TV Era	27.85	70.66%	47.53	-62.82%	17.67	14.09%	20.16
TV Pink Mak	1.64	37.20%	2.25	-100.00%	-	-	-
TV KRT	0.74	-33.78%	0.49	-26.53%	0.36	144.44%	0.88
TV MTM	7.5	3.87%	7.79	21.18%	9.44	-3.60%	9.1
TV Skajnet	7.85	-39.62%	4.74	-40.72%	2.81	24.56%	3.5


gjithsej 88.22 -2.66% 85.87 -35.12% 55.71 3.28% 57.54

Në dallim nga televizionet në nivel shteti, të cilat në vitin e analizuar kanë shënuar të hyra vetëm nga reklamimet dhe sponsorimet, te televizionet rajonale vërehet pjesëmarrja edhe e të hyrave nga shitja e programeve, nga donacionet dhe grantet, si dhe e të hyrave nga programe të tjera. Megjithatë, me rëndësi është të theksohet se shumën e përgjithshme të të hyrave nga programet tjera e ka paraqitur vetëm një televizion - TV Shutel, donacionet dhe grantet vetëm TV BTR, ndërsa të hyrat nga shitja e programeve vetëm TV MTM.

Struktura e të hyrave te televizionet rajonale	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshoping	31.88	55.41%
Sponsorime	0.29	0.50%
Të hyra nga programe të tjera	0.18	0.32%
Donacione dhe grante	2.19	3.80%
Shitje programesh	1.29	2.24%
Të hyra të tjera të paspërndara	10.41	18.10%
Të hyra nga veprimtaria bazë	46.24	80.36%
Të hyra nga veprimtari të tjera	10.61	18.45%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.69	1.19%
Gjithsej të hyra	57.54	100.00%

Shitja e kohës për reklamim ka qenë burimi më i rëndësishëm i të hyrave edhe për televizionet rajonale, por me pjesëmarrje më të vogël në të hyrat e përgjithshme se sa te televizionet terestriale në nivel shteti (89,69%) dhe te televizionet satelitore (97,95%). Televizionet rajonale kanë shënuar 55,41% të të hyrave të përgjithshme nga reklamat.

pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme nga rekl: televiziv rajonal



Më atraktive për shpallësit ka qenë TV ERA, që arriti të shënojë pothuajse gjysmën (48,68%) e të hyrave në tregun televiziv rajonal, përkatësisht 15,52 milionë denarë. Të hyra më të dukshme kanë shënuar TV MTM (4,33 milionë denarë) dhe TV Skajnet (3,31 milionë denarë).


Shuma e përgjithshme e të hyrave e TV Skopje (10,26 milionë denarë) është realizuar nga veprimtari të tjera. Sipas informatave që janë marrë nga ky radiopërhapës, bëhet fjalë për të hyra nga dhënia me qira e pajisjes dhe dhënia me qira e objektit për vendosjen e transmetuesit.

Në vitin 2012, nëntë televizionet rajonale bashkë kanë harxhuar gjithsej 87,37 milionë denarë, që është shuma më e vogël në periudhën prej pesë viteve të fundit.

Duke marrë parasysh se TV Pink Mak gjatë periudhës së tubimit të të dhënave për punën ekonomike të radiopërhapësve tashmë e kishte humbur lejen për të kryer veprimtari radiodifuzive, në grafikun më poshtë janë paraqitur të dhënat për harxhimet e televizioneve rajonale, si shumë e përgjithshme, ku janë përfshirë edhe shpenzimet e përgjithshme të TV Pink Mak (në periudhën prej 2008 deri në vitin 2011), si dhe shuma ku janë llogaritur shpenzimet e përgjithshme vetëm për nëntë televizionet, për punën e të cilave Këshilli ka të dhënat¹⁵.

¹⁵ Shpenzimet e përgjithshme të TV Pink Mak në vitin 2008 ishin 6,66 milionë denarë, në vitin 2009 - 4,43 milionë denarë, në vitin 2010 - 13,82 milionë denarë dhe në vitin 2011 - 27,49 milionë denarë.

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme



Shpenzimet e përgjithshme të këtyre nëntë subjekteve në vitin 2012 janë për 44,39% më të ulëta se shpenzimet në vitin 2008, për 53,23% më të ulëta se shpenzimet në vitin 2009, për 22,99% më të ulëta se në vitin 2010 dhe për 9,29% më të ulëta se shpenzimet që janë bërë në vitin 2011.

Më shumë mjete televizionet rajonale kanë harxhuar në vitin 2009; kjo për shkak të shpenzimeve të larta të cilat në këtë vit kanë treguar TV Skopje (116,83 milionë denarë) dhe TV Era (42,44 milionë denarë).

Ulja e shpenzimeve të përgjithshme në raport me vitin e mëparshëm (për 9,29%), është bërë shkak i shpenzimeve të përgjithshme të TV Skopje (për 16,33%, përkatësisht për 7,72 milionë denarë), të TV Era (për 15,86%, përkatësisht për 3,78 milionë denarë) dhe të TV MTM (për 3,43%, përkatësisht për 0,32 milionë denarë).

Gjashtë televizionet tjera kanë harxhuar më shumë mjete se një vit më parë.

Stacioni TV	shpenzime të përgjithshme		Shkalla e rritjes
	2012	2011	
TV Shutel	2.54	2.25	13.23%
TV Skopje	39.53	47.24	-16.33%
TV Amazon	1.68	1.05	60.44%
TV BTR	5.46	5.21	4.92%
TV Edo	3.06	3.02	1.48%
TV Era	20.07	23.85	-15.86%
TV KRT	1.01	0.69	45.50%
TV MTM	8.98	9.30	-3.43%
TV Skajnet	5.03	3.71	35.58%
Gjithsej	87.37	96.32	-9.29%

Shpenzimet direkte për krijimin e programit marrin pjesë me vetëm 26,38% në shpenzimet e përgjithshme të televizioneve rajonale.

Pjesëmarrje më të lartë në shpenzimet e përgjithshme kanë shpenzimet për amortizimin e pajisjes (33,35%); kjo për shkak të shumës së lartë për këtë lloj shpenzimi që ka paraqitur TV Skopje (24,52 milionë denarë).

Shpenzime për sigurimin e programit kanë paraqitur vetëm katër televizione: TV Shutel (0,12 milionë denarë), TV Amazon (0,62 milionë denarë), TV BTR (1,59 milionë denarë) dhe TV MTM (0,36 milionë denarë).

Pothuajse 79% të shpenzimeve për rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit kanë paraqitur TV Era (3,94 milionë denarë) dhe TV MTM (3,88 milionë denarë).


Shpenzime më të larta për rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit ka paraqitur TV Skopje (5,2 milionë denarë).

Struktura e shpenzimeve te televizionet rajonale	2012	pjesëmarrja
Shpenzime material	3.98	4.56%
Shpenzime për sigurimin e programit	2.69	3.08%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	6.47	7.40%

Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	9.91	11.34%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	23.05	26.38%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	7.70	8.81%
Amortizimi i pajisjes	29.14	33.35%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.00	0.00%
Qiraja dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	3.00	3.43%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	23.51	26.91%
Shpenzime të përgjithshme të punës	86.40	98.89%
Të dala nga aktivitetet e tjera	0.86	0.99%
Të dala të jashtëzakonshme	0.11	0.12%
Shpenzime të përgjithshme të punës	87.37	100.00%

Nga nëntë televizione rajonale, 5 kanë shënuar fitim (TV BTR, TV Shutel, TV Era, TV Amazon dhe TV MTM). Fitim më të lartë ka shënuar TV BTR (0,88 milionë denarë).

Rezultat më të keq financiar në punë ka pasur TV Skopje – humbje në shumë prej 29,27 milionë denarë. Me humbje kanë punuar edhe TV KRT, TV Edo dhe TV Skajnet.



Në nëntë televizionet rajonale, numri mesatar i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune ka qenë 49 persona. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë të punësuar në TV Era (16), TV MTM (14) dhe në TV Skopje (10).

Stacioni TV	Numri mesatar i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune			
	2009	2010	2011	2012
TV Era	22	22	16	16
TV MTM	16	15	17	14
TV Skopje	141	11	11	10
TV Edo	3	3	3	3
TV Amazon	2	2	2	2
TV Shutel	2	2	2	1
TV BTR	1	1	1	1
TV KRT	1	1	1	1
TV Skajnet	1	1	1	1
TV PINK MAK	8	6	0	-
Gjithsej	197	64	54	49

Në katër televizione rajonale (TV Shutel, TV BTR, TV KRT dhe TV Skajnet) në marrëdhënie të rregullt pune kanë qenë të punësuar vetëm nga një person.

Në krahasim me një vit më parë, numrin e të punësuarve e kanë ulur tre televizione: TV MTM (për 3 persona) dhe TV Skopje e TV Shutel me nga një person.

Te gjashtë subjektet tjera, numri mesatar i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune ka mbetur i pandryshuar.

1.5. Stacione televizive në nivel lokal

Në vitin 2012, në Republikën e Maqedonisë leje për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive – televizion në nivel lokal kanë pasur 49 subjekte.

Numri më i madh i televizioneve lokale që kanë emetuar program kanë qenë në Tetovë (pesë) dhe në Kumanovë (katër).

vendbanimi	numri i banorëve ¹⁶	numri i stacioneve TV lokale	gjuha në të cilën emetohet programi	vendbanimi	numri i banorëve ¹⁷	numri i stacioneve TV lokale	gjuha në të cilën emetohet programi
Tetovë	90,140	5	3 në shqip dhe 2 në gjuhën maqedonase	Berovë	13,337	1	gjuhë maqedonase
Kumanovë	107,632	4	2 në shqip dhe 2 në gjuhën maqedonase	Vallandovë	11,944	1	gjuhë maqedonase
Kërçovë	30,269	3	2 në shqip dhe 1 në gjuhën maqedonase	Gjevgjeli	22,934	1	gjuhë maqedonase
Ohër	54,269	3	të trijat në maqedonisht	Dibër	20,371	1	gjuhë shqipe
Strugë	64,657	3	një në shqip, një në maqedonisht dhe një në shqip e në gjuhën maqedonase	Dellçevë	16,848	1	gjuhë maqedonase
Manastir	93,380	2	gjuhë maqedonase	Dollneni	13,817	1	boshnjakisht, maqedonisht dhe në gjuhën shqipe
Veles	55,057	2	gjuhë maqedonase një në shqip dhe një në shqip, turqisht dhe në gjuhën maqedonase	Kratovë	9,784	1	gjuhë maqedonase
Gostivar	82,725	2	gjuhë maqedonase	Kriva Pallanka	20,377	1	gjuhë maqedonase
Kavadarc	39,011	2	gjuhë maqedonase	Pllasnica	4,774	1	gjuhë maqedonase
Koçanë	38,155	2	gjuhë maqedonase	Prilep	76,236	1	gjuhë maqedonase
Radovish	28,748	2	gjuhë maqedonase	Probishtip	15,590	1	gjuhë maqedonase
Strumicë	56,280	2	gjuhë maqedonase	Sveti Nikollë	18,060	1	gjuhë maqedonase
Shtip	48,598	2	gjuhë maqedonase	Qendra Zhupë	6,921	1	gjuhë maqedonase, turqisht dhe shqip

¹⁶ „Përlllogaritje të popullsisë më 30.06.2011 dhe 31.12.2011 sipas gjinisë dhe moshës, sipas komunave dhe sipas rajoneve statistikore (3 - 2007)“, Enti Shtetëror i Statistikës, e arritshme në <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.12.08.pdf>

¹⁷ „Përlllogaritje të popullsisë më 30.06.2011 dhe 31.12.2011 sipas gjinisë dhe moshës, sipas komunave dhe sipas rajoneve statistikore (3 - 2007)“, Enti Shtetëror i Statistikës, e arritshme në <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.12.08.pdf>

Numri i stacioneve televizive lokale, pavarësisht numrit të popullsisë, është më i madh në ato vendbanime ku popullsia është me përkatësi të ndryshme etnike, me qëllim që të sigurohen media të cilat programin e tyre do ta emetojnë në gjuhët që i flet/i kupton publiku i asaj zone.

Nga 49 televizione lokale, 47 kanë emetuar program gjatë tërë vitit, ndërsa dy prej tyreve (TV Novatel – Plus¹⁸ nga Prilepi dhe TV Medi¹⁹ nga Manastiri) gjatë vitit të analizuar iu mora leja për të kryer veprimtari radiodifuzive.

Në analizë janë paraqitur të dhënat për punën ekonomike të gjithsej 45 stacioneve TV lokale²⁰.

Të hyrat e përgjithshme që këto 45 televizione kanë shënuar në vitin 2012 kanë qenë 145,7 milionë denarë.

nr.r.	vendbanimi	të hyra të përgjithshme	numri i TV lokale	nr.r.	vendbanimi	të hyra të përgjithshme	numri i TV lokale
1	Manastir	24.34	2	14	Kriva Pallanka	3.65	1
2	Tetovë	21.28	5	15	Sveti Nikollë	2.65	1
3	Ohër	11.15 ²¹	3	16	Probishtip	2.61	1
4	Shtip	10.74	2	17	Gjevgjeli	2.42	1
5	Kumanovë	9.80	4	18	Dellçevë	2.26	1
6	Strumicë	9.07	2	19	Gostivar	2.20	2
7	Kavadarc	6.35	2	20	Qendra Zhupë	2.08	1
8	Veles	6.35	2	21	Vallandovë	1.98	1
9	Kërçovë	5.91	3	22	Dibër	0.77	1
10	Radovish	5.65	2	23	Makedonski Brod	0.51	1
11	Koçanë	5.42	2	24	Dollneni	0.13	1
12	Strugë	4.22	3	25	Kratovë	0.00	1
13	Prilep	4.16	1	26	Berovë	nkdh.	1
GJITHSEJ						145.7	47

nkdh. - nuk ka të dhëna


¹⁸ Për shkak të mosfillimit të veprimtarisë radiodifuzive, me Vendim nr. 07-404 dt. 24.11.2012.

¹⁹ Për shkak se nuk është paguar kompensimi për lejen në afatin e përcaktuar në leje, me Vendim nr. 07-159 dt. 31.05.2012.

²⁰ TV TOP nga Berova, gjatë periudhës së përpilimit të analizës tashmë e kishte humbur lejen për emetim (me Vendim nr.07-170 dt. 23.05.2013), ndërsa TV NTV nga Ohri nuk i dorëzoi të dhënat, për të cilën gjë Këshilli në pajtim me kompetencat e veta ligjore i shqiptoi masë. Në vitin 2011, të hyrat e përgjithshme të TV Top nga Berova kanë qenë 0,24 milionë denarë, ndërsa të TV NTV nga Ohri 2,54 milionë denarë.


²¹ Në këtë shumë janë përfshirë të hyrat e vetëm dy televizioneve – TVM dhe TV Moris, duke qenë se TV NTV nuk i dorëzoi të dhënat.

Të hyrat që janë realizuar në zonën e Manastirit dhe të Tetovës përbëjnë 31,32% nga të hyrat e përgjithshme në tregun televiziv lokal. Dy televizionet që kanë emetuar program në zonën e Manastirit kanë shënuar 16,71%, ndërsa pesë televizionet që kanë emetuar program në zonën e Tetovës kanë shënuar 14,61% nga të hyrat e të gjitha stacioneve televizive lokale.



Në periudhën e pesë viteve të fundit, vetëm në vitin 2011, në tregun televiziv lokal janë realizuar më shumë të hyra se sa në vitin e analizuar (për 4,09%).

lëvizjet e të hyrave të përgjithshme të televizi pesë vitet e fundit




Shkalla e rritjes në raport me të hyrat e përgjithshme që janë realizuar në tre vitet tjera ka vlera pozitive, edhe atë: për vitin 2008 është 25,24%, për vitin 2009 është 11,96% dhe për vitin 2010 është 41,91%.

Burimi më i rëndësishëm i të hyrave për televizionet lokale ka qenë shitja e kohës për reklamim.

Struktura e të hyrave te televizionet lokale	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshoping	125.29	85.99%
Sponsorime	0.73	0.50%
Të hyra nga programe të tjera	0.08	0.05%
Donacione dhe grante	0.00	0.00%
Shitje programesh	3.95	2.71%
Të hyra të tjera të pashpërndara	3.39	2.33%
Të hyra nga veprimtaria bazë	133.44	91.59%
Të hyra nga veprimtari të tjera	6.32	4.34%
Të hyra të jashtëzakonshme	5.93	4.07%
Gjithsej të hyra	145.70	100.00%

TV Kiss nga Tetova ka arritur të shënojë të hyra më të larta nga reklamimi (8,79 milionë denarë), ndërkaq të hyra më të dukshme kanë shënuar edhe TVM nga Ohri (7,54 milionë denarë) dhe TV Tera nga Manastiri (7,27 milionë denarë).

pjesëmarrja e tregut televiziv lokal në të hyrat e përgjithshme r



Të hyra nga sponsorimet kanë paraqitur vetëm katë televizione lokale: TV Tera nga Manastiri, TV Çegrani Media nga Gostivari, TV Emi nga Radovishi dhe TV Dibra nga Dibra.

Shumën e përgjithshme të të hyrave të përgjithshme nga programet tjera e ka shënuar TV Çegrani Media nga Gostivari, ndërsa të të hyrave nga shitja e programeve TV Tera nga Manastiri.

Pjesëmarrja e të hyrave nga veprimtaritë tjera prej 4,34% në të hyrat e përgjithshme të realizuara në tregun televiziv lokal vjen nga shumat e larta që i kanë paraqitur TV Tera nga Manastiri (2,59 milionë denarë) dhe TV Boem nga Kërçova (1,97 milionë denarë). Pothuajse 80% nga të hyrat e jashtëzakonshme janë shënuar nga TV Orbis nga Manastiri nga të hyrat e jashtëzakonshme (4,7 milionë denarë).

Në vitin 2012, stacionet televizive lokale bashkë kanë harxhuar 126,41 milionë denarë.


Shpenzime më të larta kanë paraqitur TV Tera nga Manastiri (13,72 milionë denarë), TV Kiss nga Tetova (9,02 milionë denarë), TV Orbis nga Manastiri (8,75 milionë denarë) dhe TVM nga Ohri (7,55 milionë denarë). Shpenzimet e këtyre katër subjekteve përbëjnë 30% e shpenzimeve të përgjithshme të të gjitha televizioneve lokale.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve janë bërë për rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit (25,01% nga shpenzimet gjithsej). Më së shumti mjete për këtë lloj shpenzimi kanë ndarë: TVM nga Ohri (2,42 milionë denarë), TV Iris nga Shtipi (2,27 milionë denarë) dhe TV Tera nga Manastiri (1,96 milionë denarë).

Struktura e shpenzimeve te televizionet lokale	2012	pjesëmarrja
Shpenzime materiale	24.54	19.42%
Shpenzime për sigurimin e programit	9.97	7.89%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	15.04	11.90%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	31.61	25.01%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	81.16	64.21%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	5.14	4.07%
Amortizimi i pajisjes	11.92	9.43%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.09	0.07%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	2.55	2.02%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	22.21	17.57%
Shpenzime të përgjithshme të punës	123.08	97.37%
Të dala nga aktivitetet të tjera	3.12	2.47%
Të dala të jashtëzakonshme	0.21	0.17%
Shpenzime të përgjithshme të punës	126.41	100.00%

Shpenzime për sigurimin e programit kanë paraqitur gjithsej 11 televizione lokale, e më së shumti TV Tera nga Manastiri (7,23 milionë denarë, përkatësisht 73% nga shpenzimet e përgjithshme për sigurimin e programit të televizioneve lokale).

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme të televi pesë vitet e fundit



Në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2012 televizionet lokale kanë harxhuar më pak mjete në vitin 2010 (96,64 milionë denarë), ndërsa më shumë në vitin e fundit (126,41 milionë denarë).

Shpenzimet e përgjithshme që kanë bërë televizionet lokale në vitin 2012 janë për 16,09% më të larta se sa shpenzimet në vitin 2008, për 10,45% më të larta se sa shpenzimet në vitin 2009, për 30,81% më të larta se sa në vitin 2010 dhe për 1,27% më të larta se sa shpenzimet nga një vit më parë.

Rezultati i përbashkët i arritur nga puna e tregut televiziv lokal ka qenë me fitim në shumë prej 18,98 milionë denarësh.

Rezultati i arritur nga puna e televizioneve në nivel lokal	2012
Të hyra nga veprimtaria bazë	136.61
Shpenzime të përgjithshme të punës	126.03
Fitim (humbje) nga veprimtaria bazë	10.58
Të hyra nga aktivitete të tjera	3.63
Të dala nga aktivitete të tjera	0.26
Fitim (humbje) nga aktivitete të tjera	3.37
Të hyra të jashtëzakonshme	5.45
Të dala të jashtëzakonshme	0.11
Fitim (humbje) para tatimit	19.29
Fitim (humbje) pas tatimit (fitim/humbje neto)	18.98

Rezultat financiar më të mirë kanë shënuar: TV Zllaten Kanal nga Kriva Pallanka (fitim në shumë prej 2,00 milionë denarë), TVM nga Ohri (1,89 milionë denarë), TV Orbis nga Manastiri (1,76 milionë denarë) dhe TV Moris nga Ohri (1,70 milionë denarë). Krahas këtyre katrave, edhe 35 televizione lokale vitin e kanë mbyllur me rezultat pozitiv.

Në vitin 2012, vetëm gjashtë televizione lokale kanë punuar me humbje (TV Sitel 2 nga Kratova, TV Llazhani nga Llazhani, TV Iris nga Shtipi, TV Super Skaj nga Tetova, TV Art Kanal nga Struga dhe TV Festa nga Kumanova).

Numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune në televizionet lokale ka qenë 212 persona, përkatësisht 29 persona më shumë se një vit më parë.

Gjithsej 16 televizione e kanë rritur numrin e të punësuarve: TV Kanal 8 nga Koçana dhe TV Tikveshia nga Kavadarci me nga pesë persona, TV Nova nga Kumanova me katër persona, TV Koha nga Tetova, TV Orbis nga Manastiri, TV Zllaten Kanal nga Kriva Pallanka dhe TV Intel nga Strumica me nga tre persona, TVM nga Ohri dhe TV Iris nga Shtipi me nga dy persona dhe TV Tera nga Manastiri, TV Spektra nga Struga, TV Art nga Tetova, TV Dibra nga Dibra, TV Çegrani Media nga Gostivari, TV Boem nga Kërçova dhe TV Due nga Gostivari me nga një person.

Numrin e të punësuarve e kanë zvogëluar vetëm katër televizione: TV Kiss nga Tetova dhe TV Koçana LD nga Koçana me nga dy persona, ndërsa TV Protel nga Probishtipi dhe TV Uskana nga Kërçova me nga një person.

Stacioni TV	2008	2009	2010	2011	2012	Stacioni TV	2008	2009	2010	2011	2012
TV Tera, Manastir	8	13	8	12	13	TV D1, Dellçevë	0	3	3	3	3
TVM, Ohër	12	13	12	11	13	TV Kobra, Radovish	3	3	2	3	3
TV Kiss, Tetovë	17	15	15	13	11	TV Gurra, Kërçovë	1	1	2	3	3
TV KTV-41, Kavadarç	5	5	12	11	11	TV Uskana, Kërçovë	nkdh	nkdh	2	3	2
TV Iris, Shtip	Nkdh	10	10	9	11	TV Kaltrina, Strugë	3	3	2	2	2
TV Star, Shtip	7	4	8	10	10	TV Nova, Gjevgjeli	3	2	2	2	2
TV Nova, Kumanovë	5	5	5	5	9	TV Zdravkin, Veles	2	2	2	2	2
TV Koha, Tetovë	4	4	4	5	8	TV Svet, Sveti Nikollë	2	2	2	2	2
TV Kanal 8, Koçanë	0	0	2	3	8	TV Festa, Kumanovë	nkdh	2	2	2	2
TV Emi, Radovish	7	8	7	7	7	TV Çegrani Media	0	2	2	1	2
TV Vis, Strumicë	7	7	7	7	7	TV Boem, Kërçovë	2	1	2	1	2
TV Orbis, Manastir	5	4	5	4	7	TV Due, Gostivar	2	2	1	1	2
TV Vision-BM (TV Kanal Vizija), Prilep	1	1	2	7	7	TV Hana, Kumanovë	1	1	3	1	1
TV Tikveshia, Kavadarç	0	6	4	2	7	TV Moris, Ohër	1	1	1	1	1
TV Kanal 3, Qendra Zhupë	2	2	3	6	6	TV Llazhani, Llazhani	1	1	1	1	1
TV Zllaten Kanal, Kriva Pallanka	0	4	3	3	6	TV VTV, Vallandovë	2	nkdh	nkdh	1	1
TV Kanal 21, Veles	3	3	4	5	5	TV Art Kanal, Strugë	2	2	nkdh	1	1
TV Spektra, Strugë	3	3	4	4	5	TV Dallga KRT, Kumanovë	1	1	nkdh	1	1
TV Art, Tetovë	5	3	3	4	5	TV Anisa, Pllasnica	1	1	1	1	1
TV Intel, Strumicë	4	2	2	2	5	TV Super Skaj, Tetovë	0	0	1	1	1
TV Koçana-LD, Koçanë	0	4	5	6	4	TV Sitel 2, Kratovë	0	0	0	0	0
TV Protel, Probishtip	2	2	3	5	4	TV NTV, Ohër	nkdh	1	1	1	nkdh
TV Menada, Tetovë	7	7	2	4	4	TV Top TV, Berovë	0	1	1	1	nkdh
TV Dibra, Dibër	-	-	-	3	4						
GJITHSEJ							131	157	163	183	212

nkdh - nuk ka të dhëna

INDUSTRIA E RADIOS

	të hyra të përgjithshme	të hyra nga reklama	shpenzime të përgjithshme	rezultate të punës	numri i të punësuarve
Radio Maqedonase	339.16	1.04	304.17	28.05	276
Antena 5	29.93	29.23	29.23	0.12	14
Kanal 77	24.09	15.63	16.65	7.4	6
Metropolis	2.00	2.01	1.81	0.19	0
Radiostacione rajonale	55.83	49.15	52.34	3.27	63
Radiostacione lokale	34.95	31.85	32.88	2.06	86
GJITHSEJ	485.96	128.91	437.08	41.09	445

- Në vitin 2012, në industrinë e radios janë realizuar të hyra të përgjithshme në shumë prej 485,96 milionë denarësh. 70% e kësaj shume kanë qenë të hyra të Radios Maqedonase.
- Të hyrat nga reklamimi që bashkë kanë shënuar të gjitha radiostacionet kanë qenë 128,91 milionë denarë. Të tre radiostacionet komerciale në nivel shteti kanë shënuar 36% e këtyre mjeteve, radiostacionet rajonale 38%, lokalet 25%, ndërsa Radioja Maqedonase vetëm 1%.
- Shpenzimet që kanë bërë të gjitha radiostacionet, përfshi edhe servis publik, kanë shënuar 437,08 milionë denarë. Shpenzimet e Radios Maqedonase përbëjnë 70% e kësaj shume.
- Në të gjitha segmentet e industrisë së radios janë shënuar rezultate pozitive të punës.
- Në marrëdhënie të rregullt pune kanë qenë të punësuar 445 persona, prej të cilëve 62% në sektorin publik, ndërsa 38% në sektorin privat.

2.1. Radioja Maqedonase

Të hyrat e përgjithshme të cilat në vitin 2012 i ka realizuar Radioja Maqedonase kanë shënuar 339,16 milionë denarë.²²

Në periudhën prej vitit 2008 e kënde, këto janë të hyrat e përgjithshme më të larta të Radios Maqedonase, edhe atë: për 15,13% më të larta se të hyrat në vitin 2008, për 147,69% më të larta se në vitin 2009, për 85,57% më të larta se në vitin 2010 dhe për 6,71% më të larta se të hyrat e realizuara një vit më parë.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme të Radios pesë vitet e fundit



Pjesëmarrje dominante në të hyrat e përgjithshme të Radios Maqedonase ka taksa radiodifuzive (71,19%). Pjesëmarrja e lartë e taksës radiodifuzive ka të bëjë me mënyrën kontabilare të evidentimit të këtyre të hyrave, më saktë është paraqitur shuma e faturuar e taksës radiodifuzive, e jo shuma e paguar. Këshilli kërkoi nga Radiotelevizioni Maqedonas që në mënyrë plotësuese t'i dorëzojë të dhënat për shumën e mjeteve nga taksa radiodifuzive që është paguar në këtë vit. Sipas kësaj të dhëne, në vitin 2012 janë paguar vetëm 36,71% nga vlera e faturuar, përkatësisht 88,64 milionë denarë.

²² Radiotelevizioni Maqedonas nuk mban kontabilitet të veçantë për serviset programore televizive dhe të radios. Vetëm për nevojat e kësaj Analize bëri ndarjen e të dhënave.

lëvizja e të hyrave nga taksa radiodifuzive në r



Në vitin 2012, nga shitja e kohës për reklamim Radioja Maqedonase ka realizuar 1,04 milionë denarë, ndërsa nga sponsorimet 3,63 milionë denarë.

Mjetet tjera janë realizuar nga „të hyra të tjera të pashpërndara“.


Struktura e të hyrave te Radioja Maqedonase	2012	pjesëmarrja
Taksa radiodifuzive	241.45 ²³	71.19%
Reklama dhe teleshoping	1.04	0.31%
Sponsorime	3.63	1.07%
Të hyra nga programe të tjera	0.00	0.00%
Donacione dhe grante	0.00	0.00%
Shitje programesh	0.00	0.00%
Të hyra të tjera të pashpërndara	93.04	27.43%
Të hyra nga veprimtaria bazë	339.16	100.00%
Të hyra nga veprimtari të tjera	0.00	0.00%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.00	0.00%
Gjithsej të hyra	339.16	100.00%

Shpenzimet e përgjithshme të cilat në vitin 2012 i ka bërë Radioja Maqedonase arrijnë shumën 304,17 milionë denarë.

²³ Kjo shumë paraqet vlerën e faturuar të taksës radiodifuzive. Vlera me pagesën e bërë arrin 88,64 milionë denarë.

Këto shpenzime dukshëm janë më të larta se shpenzimet që janë bërë në katër vitet e mëparshme.

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme të Rad në pesë vitet e fundit



Pothuajse gjysma e mjeteve të harxhuara (49,24%) kanë qenë shpenzime që direkt janë të lidhura me prodhimin e programit.

Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë ndarë për rrogat dhe kompensimet tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit (67,04 milionë denarë).

Struktura e shpenzimeve te Radioja Maqedonase	2012	pjesëmarrja
Shpenzime materiale	14.10	4.64%
Shpenzime për sigurimin e programit	50.55	16.62%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	18.09	5.95%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	67.04	22.04%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	149.78	49.24%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	37.53	12.34%
Amortizimi i pajisjes	5.98	1.97%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.00	0.00%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	0.00	0.00%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	110.88	36.45%
Shpenzime të përgjithshme të punës	304.17	100.00%
Të dala nga aktivitete të tjera	0.00	0.00%
Të dala të jashtëzakonshme	0.00	0.00%
Shpenzime të përgjithshme të punës	304.17	100.00%

Shpenzimet për rrogat dhe kompensimet tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit kanë qenë 37,53 milionë denarë.

Në strukturën e shpenzimeve pjesëmarrje të rëndësishme kanë shpenzimet e kategorisë „të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës“, pjesëmarrja e të cilave në shpenzimet e përgjithshme arrin 36,45%.


Rezultatet e arritura financiare të punës janë me fitim në shumë prej 28,05 milionë denarësh.

Në vitin 2012, në Radion Maqedonase në marrëdhënie të rregullt pune kanë qenë të angazhuar gjithsej 276 persona, përkatësisht 23 persona më pak se sa në një vit më parë.

2.2. Radiostacione në nivel shteti


Në vitin 2012, të tre radiostacionet komerciale që kanë emetuar program në nivel shteti (RA Antena 5, RA Kanal 77 dhe RA Metropolis) bashkë kanë shënuar të hyra të përgjithshme në shumë prej 56,02 milionë denarë.

pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme e radii nivel shteti



Më shumë se gjysma e këtyre mjeteve kanë qenë të hyra të përgjithshme të RA Antena 5 (29,93 milionë denarë, përkatësisht 53% nga të hyrat e përgjithshme të këtij segmenti të industrisë së radios). Radiostacioni Kanal 77 ka përbërë 43% nga të hyrat e përgjithshme të të tre këtyre subjekteve, përkatësisht 24,09 milionë denarë. Më pak të hyra ka shënuar radiostacioni Metropolis (2,00 milionë denarë, përkatësisht vetëm 4% nga të hyrat e përgjithshme).


të hyrat e përgjithshme të radiostacionit shteti në pesë vitet e fundi



Të hyrat e përgjithshme të këtyre tre subjekteve kanë qenë më të larta në vitin 2011. Në pesë vitet e fundit, vetëm në vitin 2008 këto tri radiostacione bashkë kanë shënuar më pak të hyra të përgjithshme se sa në vitin 2012 (për 19,01%). Në tre vitet tjera të hyrat kanë qenë më të larta, edhe atë në vitin 2009 për 3,13%, në vitin 2010 për 17,8% dhe në vitin 2011 për 22,11%.

Në vitin 2012 që të tri radiostacionet kanë shënuar më pak të hyra se sa një vit më parë, edhe atë: RA Antena 5 për 25,18%, RA Kanal 77 për 13,84%, ndërsa RA Metropolis për 49,49%.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme të radiostacionev pesë vitet e fundit



Pjesëmarrja e të hyrave nga shitja e kohës për reklamim në të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2012 është 83,64%.

Struktura e të hyrave te radiostacionet në nivel shteti	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshopping	46.86	83.64%
Sponsorime	0.00	0.00%
Të hyra nga programe të tjera	8.44	15.06%
Donacione dhe grante	0.00	0.00%
Shitje programesh	0.00	0.00%
Të hyra të tjera të pashpërndara	0.05	0.10%
Të hyra nga veprimtaria bazë	55.35	98.79%
Të hyra nga veprimtari të tjera	0.68	1.21%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.00	0.00%
Gjithsej të hyra	56.02	100.00%

Për të tri radiostacionet, reklamimi ka qenë burimi më i rëndësishëm i të hyrave. Të hyrat nga reklamimi përbën 97,64% nga të hyrat e përgjithshme të Antena 5, 64,87% nga të hyrat e përgjithshme të Kanal 77 dhe 100% nga të hyrat e përgjithshme të Metropolis-it.

Të hyrat nga programet tjera (në këtë zë hyjnë të hyrat e realizuara mbi bazë të emetimit të përshëndetjeve dhe urimeve, emisione dhe blloqe muzikore me mesazhe SMS, lojra interaktive përmes linjës telefonike, shërbime telefonike me tarifë të veçantë etj.) marrin pjesë me 15,06% në të hyrat e përgjithshme. Të hyra të këtilla ka paraqitur vetëm radiostacioni Kanal 77.

Shpenzimet e përgjithshme që kanë bërë këto tri subjekte në vitin 2012 janë 47,69 milionë denarë.

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme të radiostacioneve në pesë vitet e fundit



Krahasuar me vitet e mëparshme, shpenzimet e përgjithshme kanë qenë më të larta për 22,19% se sa shpenzimet në vitin 2008, për 32,66% se sa shpenzimet në vitin 2009 dhe për 6,69% se sa shpenzimet në vitin 2010. Shpenzimet në vitin e analizuar kanë qenë për 7,93% më të ulëta se sa shpenzimet në vitin e mëparshëm.

Më shumë se gjysma e shpenzimeve (53,93%) kanë qenë shpenzime direkte për krijimin e programit.

Shpenzime për sigurimin e programit ka paraqitur vetëm radiostacioni Antena 5.


Shpenzime më të larta për rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit ka paraqitur Antena 5 (4,2 milionë denarë). Vetëm ky radiostacion ka pasur shpenzime për rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë të lidhur direkt me prodhimin e programit.

Radiostacioni Metropolis nuk ka paraqitur shpenzime për rroga dhe kompensime të tjera për persona të angazhuar (në marrëdhënie të rregullt pune te ky subjekt nuk ka qenë i punësuar asnjë person).

Struktura e shpenzimeve te radiostacionet në nivel shteti	2012	pjesëmarrja
Shpenzime materiale	7.79	16.34%
Shpenzime për sigurimin e programit	3.42	7.17%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	9.13	19.15%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	5.37	11.27%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	25.72	53.93%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	1.99	4.17%
Amortizimi i pajisjes	7.30	15.30%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.00	0.00%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	4.30	9.01%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	8.38	17.58%
Shpenzime të përgjithshme të punës	47.69	99.99%
Të dala nga aktivitetet të tjera	0.01	0.01%
Të dala të jashtëzakonshme	0.00	0.00%
Shpenzime të përgjithshme të punës	47.69	100.00%

Rezultatet e realizuara financiare të punës së këtyre tri radiostacioneve në vitin 2012 ka qenë fitim në shumë prej 7,71 milionë denarësh.

rezultatet e arritura gjatë punës në tre v



Të tri radiostacionet kanë shënuar rezultat financiar pozitiv, edhe atë RA Antena 5 fitim në shumë prej 0,12 milionë denarë, RA Kanal 77 fitim në shumë prej 7,39 milionë denarë dhe RA Metropolis fitim në shumë prej 0,19 milionë denarë.

Radiostacioni	Numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune				
	2008	2009	2010	2011	2012
Antena 5	13	13	14	14	14
Kanal 77	5	4	5	6	6
Metropolis	1	0	0	0	0
gjithsej	19	17	19	20	20


Në vitin 2012, numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune ka qenë 20 persona, prej të cilëve 14 në Antena 5, ndërsa 6 në Kanal 77.

Në katër vitet e fundit radiostacioni Metropolis nuk ka pasur asnjë person në marrëdhënie të rregullt pune.

RA Antena 5

Në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2011, të hyrat e përgjithshme të radiostacionit Antena 5 nga viti në vit janë rritur, duke arritur në vitin 2011 vlerë prej 40,00 milionë denarë. Në vitin 2012, të hyrat kanë rënë, edhe atë për 25,18% në raport me të hyrat e realizuara në vitin e mëparshëm.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme dhe e shërbimeve të përgjithshme të RA Antena 5 në pesë vitet e fundit




Më pak mjete ky radiostacion ka harxhuar në vitin 2009 (21,06 milionë denarë). Shpenzimet që janë bërë në vitin e analizuar janë për 8,17% më të ulëta se sa ato në vitin e mëparshëm.

Në secilin prej pesë viteve të fundit ky radiopërhapës ka shënuar fitim.

Në vitin 2008 dhe në vitin 2009 numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune ka qenë 13 persona, ndërsa në tre vitet e fundit 14 persona.

RA Kanal 77

Të hyrat e përgjithshme të radiostacionit Kanal 77 nga viti 2008 deri në vitin 2011 shënojnë rritje të vazhdueshme. Viti i analizuar ka qenë më i pavoritshëm se sa vitet e mëparshme, përkatësisht të hyrat e realizuara janë për 13,84% më të ulëta se sa të hyrat në vitin 2011 dhe për 3,79% më të ulëta se sa të hyrat në vitin 2010.



Në secilin prej pesë viteve të fundit, ky radiostacion i ka rritur shpenzimet. Në vitin e analizuar mjetet e harxhuara kanë qenë për 0,12% më të larta se sa ato në vitin 2011.


Rezultatet e realizuara financiare të punës në secilin vit kanë qenë pozitive.

Numri mesatar i të punësuarve në vitin 2012 dhe në vitin 2011 ka qenë nga 6 persona, në vitin 2008 dhe 2010 nga 5 persona, ndërsa në vitin 2009 nga 4 persona.

RA Metropolis

Në periudhën prej vitit 2008 e kënde, të hyrat e përgjithshme të radiostacionit Metropolis kanë pasur vlera të ndryshueshme. Të hyra më të ulëta janë realizuar në vitin 2012 (2,00 milionë denarë), ndërsa më të larta në vitin 2009 (7,17 milionë denarë). Të hyrat në vitin 2012 kanë qenë pothuajse 50% më të ulëta se sa të hyrat në vitin e mëparshëm dhe madje për 72,11% më të ulëta se sa të hyrat në vitin më të suksesshëm 2009.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme dhe e shpënjimeve të RA Metropolis në pesë v



Shpenzimet e përgjithshme të bëra në vitin 2012 kanë qenë më të ulëta në periudhën prej pesë viteve të fundit. Në krahasim me shpenzimet e bëra në vitin e mëparshëm, shpenzimet në këtë vit kanë qenë më të ulëta për 45,81%.

Radiostacioni Metropolis vetëm në vitin 2010 ka shënuar rezultat financiar negativ. Në katër vitet tjera ka punuar me fitim.

Nga viti 2009 e kënde, asnjë person nuk është punësuar me marrëdhënie të rregullt pune.


Në vitin 2012, program në nivel rajonal (në zonën e qytetit të Shkupit) kanë emetuar gjithsej 17 radiostacione komerciale dhe një institucion radiodifuziv jopërfitues.

Në Analizë janë përpunuar të dhënat për 16 radiostacione, meqenëse në periudhën kur përgatitej ajo, një radiostacion – RA Ravel veç më nuk e kishte lejen për të ushtruar veprimtarinë radiodifuzive.²⁴

Të hyrat e përgjithshme që janë realizuar në vitin e analizuar nga ana e tregut rajonal të radios kanë arritur shumën 55,83 milionë denarë.

Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve kanë qenë të hyrat që i ka paraqitur radiostacioni Buba Mara (11,43 milionë denarë, përkatësisht 20 për qind nga të hyrat e të gjitha radiostacioneve rajonale).

pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme të radiost.




Pjesëmarrje më të dukshme kanë pasur edhe të hyrat e radiostacioneve Fortuna (7,26 milionë denarë), City-Radio (7,05 milionë denarë) dhe Radio Sportive (Sportsko radio) 90,3 FM (6,15 milionë denarë).

Edhe pse të hyrat që janë realizuar në vitin e analizuar janë më të larta se në vitin e mëparshëm (për 9,71%), ato megjithatë janë më të ulëta se sa të hyrat që janë realizuar në vitin 2008 (për 11,06%), në vitin 2009 (për 6,75%) dhe në vitin 2010 (për 4,68%).

²⁴ Më 26.12.2012, SHRT RADIO RAVEL i drejtoi Këshillit deklaratë se më nuk do të emetojë program. Konform nenit 62 të Ligjit për veprimtari radiodifuzive, Këshilli i Radiodifuzionit mori Vendim nr. 07-156/1. dt. 10.01.2013 për të ndërprerë vlefshmërinë e lejes për të kryer veprimzarti radiodifuzive.

Në vitin 2011 të hyrat e përgjithshme të këtij radiostacioni ishin 0,12 milionë denarë dhe me të hyrat e përgjithshme realizuar në tregun rajonal të radios kanë marrë pjesë me 0,2%

lëvizja e të hyrave të përgjithshme të radios në pesë vitet e fundit



Rritja e të hyrave të përgjithshme në raport me vitin e mëparshëm rezulton nga rritja e të hyrave të gjithsej të radiostacioneve: Buba Mara, Radio 90,3 FM, Life FM, Fortuna, Vat, Skaj-Radio, Haraçina dhe Jazz FM.

SHRT	të hyra të përgjithshme në miliona denarë					shkalla e rritjes 2012/2011
	2008	2009	2010	2011	2012	
Buba Mara	8.32	9.53	9.00	8.49	11.43	34.63%
City	9.92	6.47	9.23	7.64	7.05	-7.72%
Fortuna	8.12	8.84	8.63	6.55	7.26	10.84%
Vat	8.31	10.09	6.47	5.44	5.84	7.35%
RA 90,3 FM	5.02	5.29	5.46	5.25	6.15	17.14%
Life FM	1.35	2.76	4.17	4.11	4.93	19.95%
Skaj-Radio	5.66	4.95	5.27	3.52	3.69	4.83%
Sportsko Kanal 4	3.00	2.42	2.94	2.81	2.04	-27.40%
Klub FM	1.24	0.78	0.76	2.10	1.61	-23.33%
Rosa AB	2.89	2.59	1.94	1.78	1.23	-30.90%
Zona M-1	1.27	1.42	1.36	1.16	0.87	-25.00%
Folk	1.24	0.82	0.87	0.77	0.46	-40.26%
Jazz FM	0.86	0.68	0.77	0.63	0.66	4.76%
Haraçina	0.95	0.94	1.09	0.52	0.61	17.31%
RFM	-	-	-	-	0,00	-
Ravel	3.27	1.81	0.61	0.12	nkdh	-
Klasik	1.35	0.48	nkdh	nkdh	2.00	-
GJITHSEJ	62.77	59.87	58.57	50.89	55.83	9.71%

nkdh - nuk ka të dhëna

Në strukturën e të hyrave të radiostacioneve lokale, është vërejtur se në vitin e analizuar ato nuk kanë realizuar të hyra vetëm nga donacione dhe grante dhe nga shitja e programeve.


Struktura e të hyrave te radiostacionet në nivel rajonal	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshopping	49.15	88.03%
Sponsorime	1.91	3.42%
Të hyra nga programe të tjera	0.23	0.41%
Donacione dhe grante	0.00	0.00%
Shitje programesh	0.00	0.00%
Të hyra të tjera të pashpërndara	1.60	2.86%
Të hyra nga veprimtaria bazë	52.88	94.72%
Të hyra nga veprimtari të tjera	2.00	3.59%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.94	1.69%
Gjithsej të hyra	55.83	100.00%

Pjesa më e madhe nga të hyrat (88,03%) janë realizuar nga reklamat.

Më atraktiv për shpallësit ka qenë radiostacioni Buba Mara, që ka arritur të shënojë 19% e të hyrave nga reklamimi i stacioneve rajonale të radios.

Radiostacioni Fortuna ka shënuar 15%, City radio 14%, ndërsa nga 12% prej të hyrave të përgjithshme nga reklamimi në tregun rajonal të radios kanë shënuar RA 90,3 FM dhe Vat-i.

pjesëmarrja në të hyrat nga reklamimi i radiostacione




Radiostacionet RFM dhe Klasik FM nuk kanë paraqitur të hyra nga shitja e kohës për reklamim.

Të hyra nga sponsorimet kanë paraqitur vetëm RA Buba Mara dhe RA 90,3 FM, ndërkohë që shumën e përgjithshme të të hyrave nga programet tjera e ka paraqitur RA Buba Mara.

Në periudhën prej pesë viteve të fundit, vetëm në vitin 2009 radiostacionet lokale kanë harxhuar më pak mjete se sa në vitin 2012 (për 2,91%). Në krahasim me vitin e mëparshëm shpenzimet në vitin e analizuar janë për 2,75% më të ulëta.

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme të rajonale në pesë vitet e fundit



Shpenzimet direkte për krijimin e programit kanë marrë pjesë me 59,46% në shpenzimet e përgjithshme të radiostacioneve lokale. Pjesëmarrje më të dukshme prej 21,29% në shpenzimet e përgjithshme kanë pasur shpenzimet jomateriale (shërbimet).

Struktura e shpenzimeve të radiostacionet në nivel rajonal	2012	pjesëmarrja
Shpenzime material	5.31	10.14%
Shpenzime për sigurimin e programit	4.60	8.78%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	11.14	21.29%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	10.07	19.25%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	31.12	59.46%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	4.18	7.98%
Amortizimi i pajisjes	5.02	9.58%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.46	0.89%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	2.78	5.31%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	7.85	15.00%
Shpenzime të përgjithshme të punës	51.40	98.22%
Të dala nga aktivitete të tjera	0.20	0.39%
Të dala të jashtëzakonshme	0.73	1.39%
Shpenzime të përgjithshme të punës	52.34	100.00%

Shpenzime për sigurimin e programit kanë paraqitur vetëm pesë radiostacione: Haraçina, Fortuna, Klub FM, City radio dhe Zona M-1.

Shpenzime më të larta për rroga dhe kompensime të tjera për të punësuarit që direkt janë të lidhur me prodhimin e programit ka paraqitur radiostacioni City (1,87 milionë denarë), ndërsa për personat që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit radiostacioni Buba Mara (1,82 milionë denarë).

Rezultatet e realizuara të punës të radiostacioneve lokale janë me fitim në shumë prej 3,27 milionë denarë.

Rezultat financiar pozitiv kanë shënuar gjithsej 10 radiostacione: City, Buba Mara, Life FM, RA 90,3 FM, Klub FM, Fortuna, Skaj-Radio, Haraçina, Klasik FM dhe Folk radio. Fitim më të lartë kanë shënuar City radio (2,26 milionë denarë) dhe Buba Mara (1,75 milionë denarë).

Gjashtë subjektet tjera kanë shënuar rezultat financiar negativ.

Në vitin 2012, numri mesatar i të punësuarve në radiostacionet lokale ka qenë 63 persona, për dy më pak se sa në vitin 2011.

RA stacioni	2008	2009	2010	2011	2012	RA stacioni	2008	2009	2010	2011	2012
RA Fortuna	7	7	7	9	9	RA Life	2	2	2	4	4
RA City	6	8	8	9	8	RA Klub FM	3	2	2	3	3
RA Vat	11	10	10	8	8	RA Jazz FM	2	2	2	2	2
RA Sportsko radio Kanal 4	5	4	7	6	6	RA Folk	1	2	3	2	1
RA Skaj	4	5	5	5	6	RA Zona M-1	3	1	2	2	1
RA EF-EM 90,3	6	6	5	5	5	RA Haraçina	1	1	1	1	1
RA Buba Mara	4	4	5	4	5	RA Ravel	9	4	1	1	nkdh
RA Rosa AB	4	4	4	4	4	RA Klasik FM	1	0	nkdh	nkdh	0
						GJITHSEJ	69	62	64	65	63

nkdh - nuk ka të dhëna

Në krahasim me vitin e mëparshëm, numri i të punësuarve ka qenë më i madh te radiostacionet Buba Mara dhe Skaj-Radio (për nga një person). Tre radiostacione (City radio, Folk dhe Zona M-1) e kanë ulur numrin e të punësuarve për nga një person.


2.3. Radiostacione në nivel lokal

Në fillim të vitit 2012, leje që kanë emetuar radioprogram në nivel lokal kanë pasur gjithsej 60 subjekte. Gjatë vitit, radiostacioni lokal SHRT Radio Rosa nga Koçana e humbi të drejtën për të kryer veprimtari radiodifuzive.²⁵

Më poshtë janë përpunuar të dhënat për punën ekonomike të gjithsej 53 radiostacioneve lokale (SHRT Monako – Radio City FM SHPKNJP Kumanovë²⁶ në periudhën e përpilimit të Analizës tashmë e kishte humbur lejen për të kryer veprimtari radiodifuzive, ndërsa pesë radiostacione²⁷ nuk dorëzuan të dhëna për punën ekonomike në vitin 2012, për të cilën gjë Këshilli iu shqiptoi masa konform Ligjit për veprimtari radiodifuzive. Të dhënat për punën ekonomike të këtyre pesë radiostacioneve nuk u siguruan as për përpilimin e Analizës së tregut të veprimtarisë radiodifuzive për vitin 2011.

Të hyrat e përgjithshme, të cilat në vitin e analizuar bashkë i kanë shënuar radiostacionet lokale, janë 34,95 milionë denarë. Një realizim i këtillë shënon rritje të të hyrave të përgjithshme për 16,50% në krahasim me të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2008, për 11,41% në krahasim me vitin 2009 dhe për 19,73% në krahasim me të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2010.

lëvizja e të hyrave të përgjithshme të radiostacioneve lokale në pesë vitet e fundi



Vetëm në vitin 2011 janë realizuar të hyra të përgjithshme më të larta se sa në vitin e analizuar (për 6,45%). Kjo në masë më të madhe shkak i rënies së të hyrave të përgjithshme të vetëm një radiostacioni lokal – RA Kiss nga Tetova, i cili në vitin 2011 ka shënuar të hyra të përgjithshme në shumë prej 4,96 milionë denarësh, ndërsa në vitin 2012 vetëm 0,82 milionë

²⁵ Vendim për marrjen e lejes nr.07-188 dt. 06.06.2012, për shkak të mospagesës së kompensimit në afatin e përcaktuar në leje.

²⁶ Vendim për marrjen e lejes nr.07-04 dt. 10.01.2013, për shkak të mospagesës së kompensimit në afatin e përcaktuar në leje.

²⁷ RA Makedonska Kamenica nga Makedonska Kamenica, RA Di-Xhej nga Struga, RA Fokus nga Tetova, RA Energy nga Struga dhe RA Besa nga Prilepi.


denarë. Të hyrat e përgjithshme tek asnjë radiostacion tjetër nuk shënojnë aq shmangie në krahasim me vitin e mëparshëm.

Struktura e të hyrave te radiostacionet në nivel lokal	2012	pjesëmarrja
Reklama dhe teleshopping	31.85	91.15%
Sponsorime	0.92	2.63%
Të hyra nga programe të tjera	0.26	0.74%
Donacione dhe grante	0.13	0.37%
Shitje programesh	0.00	0.00%
Të hyra të tjera të pashpërndara	1.52	4.34%
Të hyra nga veprimtaria bazë	34.68	99.23%
Të hyra nga veprimtari të tjera	0.02	0.07%
Të hyra të jashtëzakonshme	0.24	0.70%
Gjithsej të hyra	34.95	100.00%

Pjesën më të madhe të të hyrave (91,15%), radiostacionet lokale e kanë shënuar nga shitja e kohës për reklamim.

Pothuajse gjysmën e mjeteve të realizuara nga reklamimi (48%) e kanë shënuar vetëm 11 radiostacione: RA Angels nga Shtipi, Super-Radio nga Ohri, RA 106 dhe RA B-97 nga Manastiri, RA Holidej nga Prilepi, RA Ekspres dhe RA Hit nga Strumica, RA Merak 5 FM nga Velesi, RA Galaksi nga Kavadarci, RA Bravo nga Kumanova dhe RA Eko nga Probishtipi.

pjesëmarrja e radiostacioneve lokale në të hyrat nga




Të hyra nga sponsorimet kanë paraqitur vetëm tri radiostacione: RA Bleta nga Tetova, RA Bravo nga Kumanova dhe RA Kometa nga Gostivari.

Të hyra nga programet tjera (në këtë zë përfshihen të hyrat e realizuara mbi bazë të emetimit të përsëritjeve dhe urimeve, emisioneve dhe blloqeve muzikore me mesazhe SMS, lojra interaktive përmes linjës telefonike, shërbimeve telefonike me tarifë të veçantë etj.) kanë paraqitur vetëm RA Tajm nga Gjevgjelia dhe RA Rrapi nga Struga.

Donacione dhe grante kanë paraqitur vetëm RA Ohri nga Ohri dhe RA Merlin nga Dibra.

Në periudhën prej vitit 2008 e këndej, radiostacionet lokale bashkë kanë harxhuar më shumë mjete në vitin 2012 (shpenzimet e përgjithshme kanë qenë 32,88 milionë denarë).

lëvizja e shpenzimeve të përgjithshme të radio në pesë vitet e fundit



Shpenzime më të larta kanë paraqitur: RA Angels nga Shtipi (1,75 milionë denarë), Super-Radio nga Ohri (1,6 milionë denarë) dhe Ekspres radio nga Strumica (1,51 milionë denarë), ndërsa më të ulëta RA Moris plus nga Makedonski Brod (0,07 milionë denarë), RA Pro-FM nga Gostivari (0,08 milionë denarë) dhe RA Merlin nga Dibra (0,1 milionë denarë).

Pjesa më e madhe (75,74%) nga shpenzimet e përgjithshme e radiostacioneve lokale kanë qenë shpenzime direkte për krijimin e programit.

Prej tyre, ndërkaq, më shumë mjete janë harxhuar për rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit (13,93 milionë denarë ose 42,37% nga shpenzimet e përgjithshme). Më shumë mjete për këtë lloj shpenzimi ka ndarë radiostacioni RA Bravo nga Kumanova (0,61 milionë denarë).

Struktura e shpenzimeve te radiostacionet në nivel lokal	2012	pjesëmarrja
Shpenzime material	6.21	18.89%
Shpenzime për sigurimin e programit	0.86	2.61%
Shpenzime jomateriale (shërbime)	3.90	11.87%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave direkt të lidhur me prodhimin e programit	13.93	42.37%
Shpenzime direkte për krijimin e programit	24.90	75.74%
Rroga dhe kompensime të tjera të personave që nuk janë direkt të lidhur me prodhimin e programit	0.62	1.89%
Amortizimi i pajisjes	1.58	4.80%
Amortizimi i të drejtave dhe licencave	0.02	0.06%
Qiratë dhe shpenzimet tjera nga detyrimet	0.56	1.70%
Të gjitha shpenzimet tjera të papërfshira të punës	4.95	15.05%
Shpenzime të përgjithshme të punës	32.64	99.26%
Të dala nga aktivitete të tjera	0.24	0.73%
Të dala të jashtëzakonshme	0.00	0.01%
Shpenzime të përgjithshme të punës	32.88	100.00%

Në vitin 2012 rezultatet e realizuara financiare të punës të të gjitha radiostacioneve lokale kanë shënuar fitim në shumë prej 2,06 milionë denarësh.

Rezultat financiar pozitiv kanë shënuar gjithsej 34 radiostacione. Rezultat financiar më të mirë kanë shënuar RA B-97 nga Manastiri (fitim në shumë prej 0,69 milionë denarë) dhe RA Bleta nga Tetova (fitim në shumë prej 0,68 milionë denarë).

Radiostacionet tjera lokale kanë shënuar rezultat financiar negativ, ndërsa më i keq ka qenë rezultati nga puna e RA Ohrit nga Ohri (humbje në shumë prej 0,57 milionë denarë) dhe e MX-Radios, gjithashtu nga Ohri (0,34 milionë denarë).

Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit 2012 në marrëdhënie të rregullt pune te radiostacionet lokale ka qenë 86 persona.

Më shumë persona (pesë) kanë qenë të punësuar në RA Ekspres nga Strumica.

Nga katër persona janë punësuar në RA Tajm nga Gjevgjelia, RA Galaksi nga Kavadarci, RA Bravo nga Kumanova dhe RA Angels nga Shtipi.

Ndërkaq, te 21 radiostacione lokale në marrëdhënie të rregullt pune kanë qenë të angazhuar vetëm nga një person.

zona	SHRT	numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune	zona	SHRT	numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune
Strumicë	RA Ekspres	5	Gostivar	RA Pro-FM	1
Gjevgjeli	RA Tajm	4	Kërçovë	RA A.Maked.	1
Kavadarc	RA Galaksi-2002	4	Kërçovë	RA Akord	1
Kumanovë	RA Bravo	4	Koçanë	RA Koçana FM	1
Shtip	RA Angels FM	4	Kumanovë	RA KMR	1
Manastir	RA 106	3	Kumanovë	RA Albana	1
Veles	RA Merak 5 FM	3	M. Brod	RA Moris plus	1
Negotinë	RA Produkcia-LGN	3	Pllasnica	RA Mis 2008	1
Prilep	RA Holidej	3	Prilep	RA Meff	1
Strumicë	RA Hit	3	Prilep	RA Ternipe	1
Tetovë	RA Kiss	3	Sveti Nikollë	RA Modea	1
Veles	RA Ce-De	2	Strugë	RA Kiki	1
Dellçevë	RA Zora	2	Strugë	RA Mi-Ni	1
Kumanovë	RA Jehona	2	Tetovë	RA Bleta	1
Ohër	RA Super	2	Kërçovë	RA Medison	1
Ohër	RA Ohri	2	Pehçevë	RA Pehçeva	1
Prilep	RA 5 Çoki	2	Zhirovnicë	RA Emi	0
Sveti Nikollë	RA Sveti Nikolla	2	Manastir	RA B-97	0
Strugë	RA Rrapi	2	Veles	RA Goldi	0
Tetovë	RA Fama	2	Dibër	RA Merlin	0
Vallandovë	RA Vallandova	2	Ohër	RA Llav	0
Probishtip	RA Eko	2	Kërçovë	RA Uskana-Plus	0
Kavadarc	RA Kavadarci	2	Ohër	RA MX (em-xhi)	0
Negotinë	RA Puls	2	M. Kamenica	RA M. Kamenica	nkdh
Berovë	RA Skaj	1	Strugë	RA Di-Xhej	nkdh
Manastir	RA Aktuel	1	Tetovë	RA Plus-Forte	nkdh
Manastir	RA Delfin	1	Tetovë	RA Fokus	nkdh
Vinicë	RA La Kosta	1	Strugë	RA Energy	nkdh
Gostivar	RA Kometa	1	Prilep	RA Besa	nkdh
GJITHSEJ					86


nkdh - nuk ka të dhëna

TË DHËNA NGA MATJA E PUBLIKUT

3.1. Të dhëna nga matja e publikut televiziv

Në secilin prej pesë viteve të fundit, koha mesatare që shikuesit maqedonas e kanë kaluar duke shikuar televizion ka arritur në mbi 4 orë.

4.1 Mesatarja e shikimit ditor (në mir vitet e fundit



Në vitin 2012, publiku maqedonas në ditë mesatarisht ka shikuar nga 274 minuta (4 orë e 34 minuta) televizion.

Nga të dhënat te grafiku 4.1 mund të vërehet se vetëm në vitin 2008 kjo kohë ka qenë më e shkurtër, edhe atë për 13 minuta. Në tre vitet tjera, publiku ka kaluar një kohë më të gjatë duke shikuar televizion, edhe atë në vitin 2009 - 12 minuta më shumë, në vitin 2010 - 19 minuta, ndërsa në vitin 2011 – 14 minuta.

Të dhënat për kohën mesatare që qytetarët e gjithsej 38 shteteve²⁸ e kanë kaluar gjatë ditës duke shikuar televizion janë siguruar nga publikacioni TV Key Facts²⁹, të cilin e përgatit dhe e publikon IP International Marketing Committee (CMI) me seli në Gjermani.

Sipas kohës që qytetarët maqedonas gjatë ditës e kanë kaluar duke shikuar televizion në vitin 2011, Maqedonia gjendet në vendin e tretë. Në vendin e parë është Republika e Serbisë, qytetarët e së cilës në ditë kanë shikuar televizion 20 minuta më shumë nga maqedonasit, ndërsa në vendin e dytë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me vetëm dy minuta më shumë prej nesh.

²⁸ Të dhënat për Belgjikën janë paraqitur veçmas për pjesën e saj veriore dhe veçmas për pjesën e saj jugore, ndërsa për Zvicrën sipas zonave gjuhësore – gjermane, frënge dhe italiane.

²⁹ Në momentin e përpilimit të këtij dokumenti, publikacioni me të dhënat për vitin 2012 ende nuk kishte dalë, prandaj janë shfrytëzuar të dhënat nga publikacioni i fundit, të cilat kanë të bëjnë me vitin 2011.

4.2. Mesatarja ditore e shikimit të televizionit në vitin 2011 (në minuta)³⁰

nr.r.	Shteti	ATV	nr.r.	Shteti	ATV
1	Serbia	308	21	Letonia	209
2	SHBA	290	22	Slllovakia	207
3	Maqedonia	288	23	Irlanda	205
4	Ukraina	286	24	Lituania	204
5	Greqia	268	25	Japonia	200
6	Kroacia	267	26	Danimarka	198
7	Rumania	257	27	Çekia	197
8	Italia	246	28	Holanda	191
9	Polonia	242	29	Belgjika (veriore)	187
10	Britania e Madhe	242	30	Sllovenia	186
11	Spanja	239	31	Bellorusia	178
12	Estonia	229	32	Qipro	174
13	Turqia	228	33	Finlanda	172
14	Franca	227	34	Zvicra (zona gjuhësore italiane)	172
15	Bullgaria	225	35	Norvegjia	168
16	Gjermania	225	36	Suedia	162
17	Belgjika (jugore)	224	37	Austria	158
18	Rusia	220	38	Zvicra (zona gjuhësore frënge)	154
19	Portugalia	219	39	Luksemburgu	151
20	Ukraina	211	40	Zvicra (zona gjuhësore gjermane)	137

Koha mesatare e shikimit të televizionit gjatë ditës në vitin 2011, për 38 shtetet, ka qenë 214 minuta (3 orë e 34 minuta). Publiku televiziv maqedonas para televizorit ka kaluar 288 minuta (4 orë e 48 minuta), përkatësisht 1 orë e 14 minuta më shumë nga mesatarja.

Të dhënat për karakteristikat demografike të publikut televiziv në Maqedoni në vitin 2012 janë paraqitur në tabelën më poshtë.

³⁰ <http://www.ip-network.com/studies-publications/international-tv-key-facts/> (hyrja është bërë më 25.01.2013)

4.3. Karakteristikat demografike të publikut

Kriteret e klasifikimit	kategoritë	AMR	ADH %
Gjinia	Mashkull	168,740	46.36%
	Femër	194,418	53.64%
Mosha	4-9	26,688	7.35%
	10-14	25,324	6.97%
	15-19	20,701	5.71%
	20-24	17,987	4.94%
	25-29	20,034	5.54%
	30-34	26,933	7.45%
	35-39	26,524	7.29%
	40-44	26,927	7.35%
	45-49	31,871	8.77%
	50-54	30,094	8.29%
	55-59	23,982	6.59%
	60-64	27,712	7.62%
	65+	58,382	16.12%
Rajoni	Shkup	100,661	27.70%
	Maqedonia veriperëndimore	90,232	24.86%
	Maqedonia jugperëndimore	72,468	19.96%
	Maqedonia lindore	99,797	27.48%
Statusi i punës	I punësuar 15+	105,290	28.99%
	I papunësuar 15+	205,856	56.68%
	Fëmijë 4-14	52,012	14.33%
Arsimi	fillor ose pa arsim	111,263	30.41%
	i mesëm	144,854	39.93%
	i lartë dhe sipëror	55,029	15.33%
	fëmijë 4-14	52,012	14.33%
Numri i anëtarëve në amvisëri	1-2	76,013	21.03%
	3-4	167,461	46.17%
	5+	119,684	32.80%
Përgjegjës për furnizimet në familje	Po	137,639	37.96%
	Jo	225,519	62.04%
Të hyra	nënmesatare	125,184	34.34%
	mesatare	165,621	45.71%
	mbimesatare	72,353	19.95%
Kombësia	Maqedonas e të tjerë	286,739	79.03%
	Shqiptarë	76,419	20.97%

Burimi: Nielsen Audience Measurement

Numri mesatar i personave që kanë shikuar televizion në vitin 2012 ka qenë 363.158, përkatësisht 19,06% nga popullsia e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë më të vjetër se 4 vjeç.


Pjesa më e madhe e publikut televiziv ka ardhur nga Shkupi (27,70%) dhe nga rajoni lindor i vendit (27,48%).

Pjesa më e madhe e shikuesve kanë qenë femra (për 7,28% më shumë se sa meshkujt). Sipas strukturës së moshës së popullsisë, pjesa më e madhe e publikut kanë qenë persona mbi 65 vjeç (16,12% e publikut).

Më shumë se gjysma e shikuesve (56,68%) kanë qenë të papunësuar, pothuajse 40% të personave me arsim të mesëm, ndërsa 62,04% të personave të cilët nuk janë përgjegjës për furnizimet në familje. Sipas lartësisë së të hyrave mujore, pjesa më e madhe e shikuesve kanë qenë persona që realizojnë të hyra mesatare mujore.

Në vitin 2012, pjesëmarrje më të madhe në shikueshmërinë e përgjithshme kanë pasur TV Sitel (28,98%) dhe TV Kanal 5 (16,71%). Në vendin e tretë është TV Alsat-M me pjesëmarrje prej 5,97%, ndërsa kanali i parë i Televizionit Maqedonas (MTV 1) është në vendin e katërt me pjesëmarrje prej 5,85%. Pjesëmarrje pothuajse të përafërt në shikueshmërinë e përgjithshme kanë pasur TV Telma (3,19%) dhe TV Alfa (3,13%).


pjesëmarrje në shikueshmërinë e pë



Pjesëmarrja e përbashkët e televizioneve rajonale dhe lokale ka qenë me 11.15% në shikueshmërinë e përgjithshme.

Edhe në këtë vit pjesëmarrje të konsiderueshme në shikueshmërinë e përgjithshme kanë pasur kanalet e huaja (19,60%), të cilat publiku i pranon përmes operatorëve të rrjeteve komunikuese publike.

pjesëmarrja në shikueshmërinë e përgjithshme në tr



Në vitin e analizuar, TV Sitel, TV Kanal 5 dhe kanali i parë i Televizionit Maqedonas (MTV 1) kanë pasur pjesëmarrje më të madhe në shikueshmërinë e përgjithshme në dallim nga shikueshmëria e mëparshme, edhe atë TV Sitel për 7,44%, TV Kanal 5 për 7,56% dhe MTV 1 për 0,46%. Pjesëmarrje më të vogël në shikueshmërinë e përgjithshme kanë pasur TV Alsats-M (për 1,10%) dhe TV Telma (për 0,11%).

Pjesëmarrja në shikueshmërinë e përgjithshme muaj për muaj

muaji	MTV 1	Sitel	Kanal 5	Alsats-M	Telma	Alfa
I	5.16%	27.97%	15.57%	7.31%	3.32%	3.10%
II	4.61%	28.12%	17.81%	7.37%	3.45%	3.17%
III	4.17%	29.12%	19.75%	6.61%	3.00%	3.41%
IV	4.32%	28.91%	19.64%	5.64%	3.03%	3.76%
V	5.28%	27.50%	20.47%	6.16%	2.79%	3.34%
VI	9.10%	30.11%	15.00%	5.50%	2.13%	2.53%
VII	6.21%	30.41%	13.88%	4.81%	2.86%	2.81%
VIII	7.75%	28.91%	10.75%	4.64%	3.22%	3.01%
IX	5.50%	30.87%	13.91%	5.56%	3.51%	3.23%
X	6.86%	29.68%	17.19%	5.29%	3.39%	2.99%
XI	6.11%	28.84%	18.17%	5.57%	3.67%	2.69%
XII	6.60%	28.63%	16.13%	5.86%	3.52%	3.35%


Në periudhën e tre viteve të fundit vetëm pjesëmarrjet e TV Sitelit dhe TV Kanal 5 në shikueshmërinë e përgjithshme janë rritur në kontinuitet.

Në secilin muaj të vitit, TV Sitel ka pasur pjesëmarrje dominante në shikueshmërinë e përgjithshme. Shikueshmëri më të madhe ky televizion ka pasur në shtator (30,87%), ndërsa më të vogël në maj (27,50%)

Sipas pjesëmarrjes në shikueshmërinë e përgjithshme, TV Kanal 5 në secilin muaj ka qenë në vendin e dytë. Pjesëmarrja e këtij stacioni televiziv është vërejtur se bie gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht, që në katër muajt e fundit përsëri të rritet.

Kanali i parë i Televizionit Maqedonas (MTV 1) ka pasur pjesëmarrje më të madhe në shikueshmërinë e përgjithshme në qershor (9,10%), për shkak të transmetimeve të ndeshjeve nga Kampionati evropian në futboll dhe në gusht (7,75%), për shkak të transmetimeve nga ngjarjet sportive në olimpiadën verore në Londër.

pjesëmarrja në shikueshmërinë e përgjithshme



Pjesëmarrjet e TV Telma, TV Alsat-M dhe TV Alfa në shikueshmërinë e përgjithshme, në secilin muaj veç e veç, nuk kanë shmangie të konsiderueshme nga shikueshmëria mesatare vjetore.

Përmbajtjet programore më të shikuara në vitin 2012

Përmbajtja programore më e shikuar në vitin 2012 ka qenë episodi i serialit turk Dashuri dhe dënim (*ASK VE CEZA*), emetuar më 6 shkurt, me rejting 32,23%. Në mesin e dhjetë përmbajtjeve programore të para më të shikuara gjenden edhe shtatë episode nga ky serial.

top 10	Stacioni TV	dita	rejtingu
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	06.02.2012	32.23%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	17.01.2012	32.06%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	18.01.2012	31.06%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	12.03.2012	30.92%
Lajme të befta	Sitel	25.01.2012	30.63%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	13.02.2012	30.47%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	27.01.2012	30.33%
Ezel/ <i>EZEL</i>	Sitel	06.02.2012	29.52%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	30.01.2012	29.40%
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	23.01.2012	29.29%

Pesëmbëdhjetë përmbajtjet programore të para më të shikuara nga zhanri i programit artistik janë emetuar në TV Sitel. Prej tyre dhjetë kanë qenë seriale, ndërsa pesë filma artistikë. Vetëm seriali „Mëkati i nënës së saj”/Гревот на нејзината мајка (në vendin e nëntë) është me prejardhje nga Republika e Serbisë, ndërsa nëntë të tjerat janë nga produksioni turk.

PROGRAM ARTISTIK (top 10)	Stacioni TV	Numri i episodeve	rejtingu
Dashuri dhe dënim/ <i>ASK VE CEZA</i>	Sitel	71	24.93%
Nëna/ <i>BAHAR DALLARI</i>	Sitel	35	19.73%
Betimi/ <i>YEMIN</i>	Sitel	43	18.53%
Lugina e ujëve Kurthi/ <i>KURTLAR VADISI PUSU</i>	Sitel	20	18.04%
Ezel/ <i>EZEL</i>	Sitel	142	17.57%
Dhëndri kollovar/ <i>YABACI DAMAT</i>	Sitel	112	17.56%
Lot vjeshte/ <i>SON BAHAR</i>	Sitel	29	17.50%
Ashtu siç koha kalon / <i>OYLE BIR GEGER ZAMANKI</i>	Sitel	145	17.13%
Mëkati i nënës së saj/ <i>ГРЕХ ЊЕНЕ МАЈКЕ</i>	Sitel	12	16.71%
Avram (pjesa 1)	Sitel	1	15.14%

Shikueshmëri më të lartë ka pasur seriali Dashuri dhe dënim (ASK VE CEZA). Janë emetuar gjithsej 71 episode, shikueshmëria mesatare e të cilave ka qenë 24,93%.

Në vendin e gjashtëmbëdhjetë gjendet seriali turk „Madhështori“, emetuar në TV Kanal 5. Shikueshmëria mesatare e 138 episodeve të këtij seriali ka qenë 12,04%.

PROGRAMI SPORTIV (top 10)	Stacioni TV	rejtingu
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Danimarka-Maqedonia	Sitel	28.77%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Serbia-Maqedonia	Sitel	27.62%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Suedia-Maqedonia	Sitel	27.25%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Çekia-Maqedonia	Sitel	25.82%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Serbia-Kroacia	Sitel	25.21%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Polonia-Maqedonia	Sitel	25.10%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Maqedonia-Slllovenia	Sitel	25.08%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Maqedonia-Gjermania	Sitel	23.75%
KE HENDBOLL MESHKUJ 2012: Serbia-Danimarka	Sitel	19.98%
LIGA E KAMPIONËVE: REAL MADRID - BAYERN M.	Kanal 5	17.01%

Nga programi sportiv në nëntë vendet e para janë transmetimet e drejtpërdrejta nga ndeshjet e reprezentacionit maqedonas në Kampionatin evropian në basketboll, të cilin në janar të vitit 2012 e emetoi TV Sitel, ndërsa në vendin e dhjetë kampionati në futboll i Ligës së kampionëve midis Real Madridit dhe Bajern Munihut, zhvilluar nga 25 prilli i vitit 2012.

Përmbajtje informative më të shikuara në vitin 2012 kanë qenë Lajmet e befta të emetuara në TV Sitel më 25 janar në orën 21:43, me kohëzgjatje prej 10 minutash, me shikueshmëri 30,63%. Bëhet fjalë për lidhjen direkte nga festimi në Sheshin Maqedonia me rastin e fitores së reprezentacionit maqedonas kundër reprezentacionit të Serbisë në Kampionatin evropian në hendboll.

Nga lajmet dhe programi informativ, shikueshmëri më të madhe kanë pasur Lajmet që i emeton TV Sitel në orën 16.00. Rejtingu mesatar i 365-të edicioneve të kësaj përmbajtjeje ka qenë 9,64%, ndërkohë që më i shikuar ka qenë edicioni i emetuar më 27 janar të vitit 2012, me shikueshmëri nga 22,12 për qind.

Në mesin e dhjetë më të shikuarave janë edhe dy paraqitjet e Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë: paraqitja në shënimin e Ditës së Luftës revolucionare maqedonase, emetuar në TV Sitel më 25 tetor, me shikueshmëri nga 8,25% dhe paraqitja me rastin e

ndodhive në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, më 24 dhjetor të vitit 2012, emetuar në TV Kanal 5.

LAJME DHE PROGRAME INFORMATIVE (top 10)	Stacioni TV	emetime	Rejtingu
Lajme 16:00	Sitel	365	9.64%
Ditari 1	Sitel	365	9.43%
Sitel-lajme biznesi 19:30	Sitel	206	9.29%
Paraqitja e Kryeministrit Nikolla Gruevski	Sitel	1	8.25%
Lajme 18:25	Kanal 5	183	8.10%
Paraqitja e Kryeministrit Nikolla Gruevski	Kanal 5	1	7.87%
Ditari 2	Sitel	364	7.24%
Hapja solemne e Portës Maqedonia	Sitel	1	6.93%
Vizita e Kryeministrit Nikolla Gruevski në Katar	Sitel	1	6.80%
Kod	Kanal 5	33	6.54%

Në vendin e tetë është transmetimi nga hapja solemne e Portës Maqedonia më 9 janar të vitit 2012, ndërsa në vendin e nëntë është raportimi nga vizita e Kryeministrit Nikolla Gruevski në Katar, emetuar më 8 prill të vitit 2012 në TV Sitel.

Në mesin e dhjetë përmbajtjeve informative më të shikuara sukses depërtues ka shënuar vetëm një emision aktual-informativ me qasje dokumentare – Kod, që emetohet në TV Kanal 5.


3.2. Të dhëna nga matja e publikut të radios

Rrezja javore mesatare

Në vitin 2012, mesatarja e rrezes javore e radiostacioneve ka arritur 50,3%, përkatësisht, në pyetjen „gjatë javës së kaluar a dëgjuat radio?“, 50,3% nga të anketuarit janë përgjigjur në mënyrë pohuese.

Në krahasim me vitin 2011, mesatarja e rrezes javore e radiostacioneve shënon rritje për 0,7% (atëherë 49,6% nga të anketuarit janë përgjigjur në mënyrë pohuese në këtë pyetje).

rrezja javore mesatare - muaj për mu




Vlerë më të lartë ky tregues ka pasur në tetor (54,6%), ndërsa më të ulët në mars (45,3%).

Radiostacioni më i dëgjuar në vitin 2012 ka qenë Antena 5. Në të vërtetë, 20% nga të anketuarit që kanë dëgjuar radio, në pyetjen „cilin radiostacion dëgjuat javën e kaluar“ janë përgjigjur me Antena 5.


Në vendin e dytë është radiostacioni Kanal 77, të cilin e kanë dëgjuar 8,5% e publikut maqedonas, ndërsa 5,9% nga të anketuarit janë përgjigjur se kanë dëgjuar Radion Maqedonase 1. Radiostacioni Metropolis është zgjedhur nga 3,10% e të anketuarve, ndërkohë që prej gjithë atyre më pak kanë dëgjuar Radion Maqedonase 2 (2,50%).

rrezja vjetore mesatare e radiostacioneve që eme nivel shteti në vitin 2012




Vetëm Radioja Maqedonase 1 ka pasur rreze më të vogël dëgjimi në vitin 2012, në krahasim me vitin e përparshëm (për 0,3%).

rrezja vjetore mesatare e radiostacioneve program në nivel shteti në vitin 2011 dhe



Rritje më e dukshme është shënuar tek Antena 5 (2% më shumë se në vitin e mëparshëm). Rrezja e radiostacioneve të tjera ka pasur rritje të pavërejtshme, Kanal 77 për 0,3%, Metropolis për 0,4% dhe Radioja Maqedonase 2 për 0,1%.

rrezja javore mesat




Në secilin muaj të vitit, pjesa më e madhe e publikut e ka dëgjuar radiostacionin Antena 5. Dëgjueshmëri më të madhe ky radiostacion ka pasur në shtator, kur 21,8% nga të anketuarit janë deklaruar se gjatë javës së mëparshme e kanë dëgjuar pikërisht këtë radiostacion, ndryshe nga muaji mars (vetëm 15,9%).

Vetëm në muajin maj, servisi i parë programor i Radios Maqedonase (RM 1) ka qenë më i dëgjuar nga Kanal 77. Në njëmbëdhjetë muajt tjerë Kanal 77 është në vendin e dytë, pas Radios Antena 5.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Antena 5	16.6	17.6	15.9	18.8	17.1	19.2	22.1	24.3	24.8	21.8	21.6	21.0
Kanal 77	7.1	5.8	7.9	8.3	6.2	7.6	9.5	9.8	9.8	11.5	9.8	9.5
Radio Maq. 1	6.5	5.7	5.1	4.5	6.8	5.8	6.3	5.8	5.4	6.6	7.1	5.2
Metropolis	3.1	2.6	2.5	2.5	2.4	3.6	3.5	4.0	3.5	3.0	3.0	3.3

Radiostacioni Antena 5 është zgjedhur më shpesh edhe nga publiku i Shkupit (25,4% e të anketuarve nga Shkupi janë përgjigjur se një javë më parë e kanë dëgjuar këtë stacion).

rrezja javore mesatare e radiostacioneve për z



Në vendin e dytë, sipas rrezes së vitit 2012, është City radio (10,3%), ndërsa në të tretin Buba Mara (7,1%).

Rrezja e radiostacionit Metropolis në zonën e Shkupit (5%) ka qenë më e madhe se sa rrezja e këtij radiostacion për tërë territorin e shtetit (3,1%).

Boton:
KËSHILLI I RADIODIFUZIONIT
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

bul. „VMRO “ nr.3, 1000 Shkup
tel. 3103-400
faks. 3103-401
http: www.srd.org.mk
e-posta: sovet@srd.org.mk

Për botuesin:
Dr. Zoran Trajçevski, kryetar i Këshillit

Përgatitën:
Magdalena D. Dovleva
Katerina Mitre

Shkup
2013